



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES

Nr. 1026/1 prot.

Tiranë, më 05.12.2025

VENDIM
Nr. 72, datë 05.12.2025

PËR
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 37, DATË 19.6.2024

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, (e ndryshuar), pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit të Zbatimit të Vendimeve Paralajmëruese dhe Koordinimit, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit nr. 37, datë 19.6.2024, të Komisionerit, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në institucionin Bashkia Belsh dhe paralajmërimin e institucionit për rregullimin e situatës së ligjshmërisë”*,

KONSTATOVA SE:

Me Vendimin nr. 101, datë 07.12.2023, *“Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, në Bashkinë Belsh”*, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, në institucionin Bashkia Belsh.

Ky proces është përmbyllur me Vendimin nr. 37, datë 19.06.2024, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Bashkisë Belsh dhe paralajmërimin e institucionit për rregullimin e ligjshmërisë, me qëllim përmirësimin e situatës”*, të Komisionerit, ku janë lënë detyra konkrete për rregullimin e ligjshmërisë.

Me kalimin e afatit të lënë në vendimin e mësipërm, Komisioneri ka urdhëruar fillimin e mbikëqyrjes në vazhdim për zbatimin e këtij vendimi, në institucionin Bashkia Belsh, me urdhrin nr. 129, datë 20.12.2024, *“Për kryerjen e mbikëqyrjes në vazhdim në lidhje me zbatimin e vendimit paralajmërues nr. 37, datë 19.6.2024, të Komisionerit”*, sipas objektit

dhe drejtimeve që përmban programi i mbikëqyrjes, i cili është pjesë e këtij urdhri. Për nisjen e këtij procesi Bashkia Belsh është njoftuar me shkresën nr. 950/2 prot., datë 20.12.2024, “Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së zbatimit të vendimit paralajmërues nr. 37, datë 19.6.2024, të Komisionerit”. Mbi bazën e këtyre akteve, grupi i punës u paraqit në subjektin e mbikëqyrjes dhe në përfundim të procesit mbajti një akt konstatimi ku u pasqyrua situata e rregullimit të ligjshmërisë dhe u administrua dokumentacioni që materializon zbatimin pjesërisht të vendimit objekt i këtij verifikimi.

Në vijim, me urdhrin nr. 51, datë 18.06.2025, “Për zhvillimin e seancave dëgjimore në kuadër të masave për zbatimin e vendimeve paralajmëruese”, të Komisionerit, njoftuar Bashkisë Belsh me shkresën nr.626/1 Prot., datë 18.06.2025, Komisioneri ka urdhëruar, ndër të tjera, zhvillimin e një seance dëgjimore në datën **23.06.2025, ora 12:00**, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të këtij subjekti, me qëllim vlerësimin e masave të marra për zbatimin e vendimit paralajmërues nr. 37, datë 19.06.2024. Ky proces është dokumentuar në procesverbalin e mbajtur për këtë seancë, ku është evidentuar situata në lidhje me masat e marra nga institucioni.

Mbështetur në detyrat e lëna në Vendimin nr. 37, datë 19.06.2024, si dhe referuar informacionit të administruar në subjekt dhe gjatë seancës dëgjimore konstatohet se, situata e administrimit të shërbimit civil në institucionin e mbikëqyrur paraqitet si më poshtë vijon:

Në **pikën 2**, të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar nga Kryetari i Bashkisë Belsh, të konstatohet pavlefshmërinë absolute të akteve të emërimit të nxjerra në kundërshtim me ligjin për 36 punonjësit e emëruar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion vërejt se në Bashkinë Belsh për punonjësit më poshtë janë ndërprerë marrëdhëniet e punësimit me institucionin. Konkretisht:

1. Punonjësi Ditjon Pepa, në pozicionin e punës “Përgjegjës Sektori”, në Sektorin e Inspektoriatit Tatimor dhe Kundravajtjeve Administrative është liruar nga detyra me urdhrin nr. 55, datë 3.7.2024;
2. Punonjësja Matea Gjoshi, në pozicionin e punës “Përgjegjës Sektori”, në Sektorin e IT dhe Turizmit është liruar nga detyra me urdhrin nr. 58, datë 3.7.2024;
3. Punonjësi Albert Hysa, në pozicionin e punës “Përgjegjës Sektori”, në Sektorin e Integritetit dhe Marrëdhëniet me Diasporën, Turizmit është liruar nga detyra me urdhrin nr. 54, datë 3.7.2024;
4. Punonjësja Ermira Budani, në pozicionin e punës “Përgjegjës Sektori”, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme është liruar nga detyra me urdhrin nr. 56, datë 3.7.2024;
5. Punonjësi Vullnet Idrizi, në pozicionin e punës “Përgjegjës Sektori”, në Drejtorinë e Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit është liruar nga detyra me urdhrin nr. 57, datë 3.7.2024;

6. Punonjësja Anxhela Drevishi, në pozicionin e punës “*Përgjegjës Sektori*”, në Sektorin e Pronave Publike është liruar nga detyra me urdhrin nr. 64, datë 8.8.2024;
7. Punonjësja Kristina Topalli, në pozicionin e punës “*Specialist Turizmi*”, në Sektorin e IT dhe Turizmit, pranë Drejtorisë së Turizmit, Teknologjisë së Informacionit, Kulturës dhe Integritit Evropian është larguar me urdhrin nr. 2317 prot., datë 8.7.2024;
8. Punonjësi Aranit Duka, në pozicionin e punës “*Specialist Bujqësie*”, pranë Drejtorisë së Zhvillimit të Bujqësisë, Pyjeve, Mjedisit dhe Pronat Publike është larguar me urdhrin nr.198, datë 10.1.2024;
9. Punonjësja Klea Sina, në pozicionin e punës “*Inspektore*”, në Sektorin e Menaxhimit Financiar është larguar me urdhrin nr.790, datë 1.3.2024;
10. Punonjësi Marenglen Tafani, në pozicionin e punës “*Specialist*”, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse është larguar me urdhrin nr.1452, datë 17.4.2024;
11. Punonjësi Qemal Rusta, në pozicionin e punës “*Drejtor Drejtorie*”, në Drejtorinë e Zhvillimit të Bujqësisë, Pyjeve, Mjedisit dhe Pronave Publike është larguar me urdhrin nr.951, datë 4.3.2024;
12. Punonjësi Avni Shtylla, në pozicionin e punës “*Përgjegjës Sektori*”, në Drejtorinë e Zhvillimit të Bujqësisë, Pyjeve, Mjedisit dhe Pronat Publike është larguar me urdhrin nr.2047, datë 13.6.2024;
13. Punonjësi Denis Agolli, në pozicionin e punës “*Drejtor Drejtorie*”, në Drejtorinë e Shërbimeve Utilitare, Komunitare dhe Administrative është larguar me urdhrin nr.1451, datë 17.4.2024;
14. Punonjësja Silvana Toska, në pozicionin e punës “*Specialist*”, në Drejtorinë e Shërbimeve Utilitare, Komunitare dhe Administrative është larguar me urdhrin nr.3123, datë 17.9.2024;
15. Punonjësja Gladiola Arapi në pozicionin e punës “*Inspektore*” në drejtorinë e Ndihmës Ekonomike, është larguar me urdhrin nr. 47, datë 9.1.2025;
16. Punonjësja Selime Gjolena në pozicionin e punës Inspektore në Drejtorinë e Ndihmës Ekonomike është larguar me urdhrin nr. 267, datë 2.6.2025;
17. Punonjësja Erjola Skena në pozicionin Specialist në Drejtorinë e Emergjencave Civile është larguar me urdhrin nr. 224, datë 12.11.2024;
18. Punonjësi Rolando Jahja, në pozicionin e punës *Specialist Bujqësie*”, pranë Drejtorisë së Zhvillimit të Bujqësisë, Pyjeve, Mjedisit dhe Pronat Publike është larguar me urdhrin nr. 70, datë 9.1.2025.
19. Punonjësi Arsen Hysa, në pozicionin e punës “*Drejtor Drejtorie*”, në Drejtorinë e Turizmit, Teknologjisë së Informacionit, Kulturës dhe Integritit Evropian, me urdhrin nr.184, datë 8.10.2024, të Kryetarit, i është bërë ndërprerja e marrëdhënies së punësimit.

**Në rastin e punonjësës Kristina Topalli rezulton 2 herë në dispozitivin e vendimit të Komisionerit.*

Sipas Urdhrit nr.121, datë 9.10.2025, “Për miratimin e strukturës Organizative të Bashkisë Belsh për vitin 2025”, pozicionet e mëposhtme kanë dalë jashtë shërbimit civil:

1. “Inspektore”, në Sektorin e Ndhmës Ekonomike
2. “Përgjegjës Sektori”, në Sektorin e Kulturës
3. “Përgjegjës Sektori”, në Sektorin e Arsimit Parashkollor pranë Bashkisë
4. “Specialist bujqësie”, pranë Bashkisë Belsh
5. “Specialist”, në Drejtorinë e Shërbimeve Utilitare, Komunitare dhe Administrative
6. “Specialist”, në Drejtorinë e Shërbimeve Utilitare, Komunitare dhe Administrative;
7. “Specialist”, në Drejtorinë e Shërbimeve Utilitare, Komunitare dhe Administrative
8. “Përgjegjës Sektori”, në Drejtorinë e Shërbimeve Utilitare, Komunitare dhe Administrative

Në lidhje me pozicionet: “Drejt看 Urbanistike”, “Specialiste Bujqësie”, “Specialiste e Ndhmës Ekonomike”, “Inspektor i të ardhurave vendore”, nëpërmjet postës elektronike, Bashkia Belsh konstaton se për këto pozicione janë bërë shpallje por nuk ka pasur asnjë kandidat dhe si pasojë e nevojave të institucionit vazhdojnë të jenë në marrëdhënie pune, të njëjtë punonjës që kanë qenë të emëruar në kundërshtim me ligjin.

Po në të njëjtin komunikim, Bashkia Belsh shprehet se:

- Bukuroshe Allka emëruar në pozicionin “Specialist Bujqësie” është me leje lindje dhe, për këtë arsye nuk janë marrë masa.
- Enian Ferhati, emëruar në pozicionin “Inspektor i të ardhurave vendore” – ky punonjës është larguar dhe pas shpalljes së vendit vakant është emëruar një punonjës me procedurën “Pranim në shërbimin civil”.
- Anxhela Dervishi e cila është emëruar në pozicionin “Përgjegjëse e Pronave Publike”, gëzon statusin e nëpunësit civil dhe ushtron detyrën në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Fjoralba Çapja emëruar në pozicionin “Specialiste e Ndhmës Ekonomike” ka kaluar në një pozicion jashtë shërbimit civil.

Në lidhje me këto raste, Bashkia Belsh nuk ka bashkëlidhur akte që provojnë zbatimin e kësaj pike të vendimit.

Në **pikën 3 të** vendimit paralajmërues, Komisioneri i ka kërkuar njësisë përgjegjëse dhe subjekteve të ngarkuara me detyra të administrimit të shërbimit civil, të rregullojnë situatën në lidhje me institutin e konfirmimit dhe deklarimit pas periudhës së provës për 4 punonjës duke ndjekur orientimet e dhëna në këtë vendim.

Vërej se, njësia përgjegjëse (njësia e burimeve njerëzore të institucionit) ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në përfundim të periudhës së provës për konfirmimin e nëpunësve civilë. Konkretisht:

- Me aktin nr. 2326 prot., datë 9.7.2024, Xhuljana Tafani konfirmohet nëpunëse civile në pozicionin, “*Inspektore e Ndihmës Ekonomike*”;
- Me aktin nr. 2325 prot., datë 9.7.2024, Adela Pepa konfirmohet nëpunëse civil në pozicionin, “*Inspektore e Ndihmës Ekonomike*”;
- Me aktin nr. 2628 prot., datë 5.8.2024, Kristina Uruci, konfirmohet nëpunëse civile në pozicionin, “*Inspektore*”, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore;
- Me aktin nr. 2626 prot., datë 5.8.2024, Julgin Rika konfirmohet nëpunës civil në pozicionin, “*Inspektor Transporti*”.

Në **pikën 4** të vendimit, Komisioneri ka kërkuar që gjatë procesit të rekrutimit të respektohet parimi i transparencës dhe procedura ligjore në të gjitha fazat e konkurrimit, duke nisur nga publikimi i shpalljeve për pozicionet e lira e deri te publikimi i fituesve, si në faqen zyrtare dhe stendën e institucionit, ashtu edhe pranë Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.

Nga aktet e administruara (*shpalljet e vendeve vakante nr. 279 prot, nr. 280prot, nr.281dhe nr 282 prot, datë 16.01.2025*) konstatoj se, njësia përgjegjëse e institucionit të Bashkisë Belsh ka realizuar 4 procedura konkurrimi për plotësimin e pozicioneve vakante, si më poshtë:

1. 2 Specialist/Inspektor i NE
2. 1 Specialist/Inspektor në Drejtorinë e Zhvillimit të Bujqësisë
3. 1 Drejtor në Drejtorinë për Planifikim, Zhvillim dhe Kontrollin e Territorit.

Në përfundim, në bazë të të gjitha gjetjeve të paraqitura më sipër, rezulton se Bashkia Belsh ka filluar të zbatojë detyrat e lëna në Vendimin Paralajmërues nr. 37, datë 19.06.2024 të Komisionerit, nëpërmjet veprimeve konkrete administrative, për të gjitha detyrat e lëna, por ende nuk e ka përfunduar atë.

Sa i takon aspektit më problematik që ka të bëjë me rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin, në kushtet kur ky proces ka një nivel kompleks vështirësie që kërkon njohuri të thelluara në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore si edhe kapacitete të mjaftueshme në përbërje dhe mbështetje të njësisë përgjegjëse për administrimin e burimeve njerëzore të institucionit, të cilat janë të kufizuara në njësitë e administratës vendore, e sidomos në këto bashki me një numër relativisht të ulët banorësh, e po kështu, duke njohur faktin se ky proces kërkon një periudhë kohore relativisht të gjatë për t’u implementuar, si për shkak të afateve procedurale, ashtu edhe për arsye të ndryshme objektive, që kryesisht qëndrojnë në mungesën e kandidatëve të interesuar për të marrë pjesë në procesin e rekrutimit, vlerësojmë se për realizimin e detyrave, institucionit duhet t’i mundësohet një afat kohor që shkon përtej atij të vendosur nga Komisioneri në vendimin e paralajmërimit.

Me synim plotësimin e detyrave të lëna në vendim, në koherencë edhe me zhvillimet aktuale, që përkohë me hartimin e strukturave të reja organizative të njësive të

administratës vendore për vitin 2026, si edhe me qëllim që këto institucione të mbështeten me asistencë teknike si nëpërmjet trajnimeve nga ASPA, ashtu edhe nga stafi i Komisionerit, për të zbatuar drejt kërkesat e ligjit dhe procedurat ligjore rast pas rasti, vlerësojmë se ndjekja e procesit të rivendosjes së ligjshmërisë, përgjatë vitit 2026, duhet të vijojë përmes mbikëqyrjes online dhe mbikëqyrjes së orientuar për implementimin e skemës së administrimit të shërbimit civil në përbërje të strukturës organizative në njësitë e vetqeverisjes vendore, të cilat janë procese që aktualisht realizohen nga stafi i Komisionerit, përgjatë gjithë vitit kalendarik.

Në këto kushte, vlerësoj se ndjekja e procesit të rivendosjes së ligjshmërisë duhet të vijojë përmes mbikëqyrjes online dhe, në varësi të ecurisë, nëse shkeljet nuk adresohen plotësisht, institucioni të jetë objekt i procedurës së mbikëqyrjes së përgjithshme apo tematike gjatë vitit 2026.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”* dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, (e ndryshuar).

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit nr. 37, datë 19.06.2024, të Komisionerit, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në institucionin Bashkia Belsh dhe paralajmërimin e institucionit për rregullimin e situatës së ligjshmërisë”*.
2. Ndjekjen e detyrave të pazbatuara, të evidentuara në pjesën arsyetuese të këtij vendimi, përmes mbikëqyrjes online dhe, në varësi të ecurisë, nëse shkeljet nuk adresohen plotësisht, institucioni të jetë objekt i procedurës së mbikëqyrjes së përgjithshme apo tematike gjatë vitit 2026.
3. Për këtë vendim të njoftohet Bashkia Belsh.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha

